



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 825/1011 REGJ.THEM
Vendimi

Nr. 439

Datë 23.02.2022

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR : ALBERT MEÇA

asistuar nga sekretare gjyqësore Mimoza Noka, në séancë gjyqësore, sot me datë **23.02.2022**, shpall këtë vendim lidhur me çështjen penale që i përket :

AKUZUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përfaqësuar nga prokuror Milan Laskaj.

KUNDËR

I PANDEHUR : Toni Shquti, i biri i Eqrem dhe i Qanije, i dtl. 21.10.1986, lindurdhe banues në Tiranë, me adresë Rruga “Myslym Shyri”, pallati. 55, ap.7. Me gjendje civile beqar, me arsim të mesëm, i dënuar edhe më parë, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”, përfaqësuar e mbrojtur nga av. Rabije Cenalia, caktuar kryesisht nga Gjykata.

AKUZUAR : Për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1i kodit penal.

PERSON NËN HETIM: Forcim Lita, i biri i Abdulla dhe i Dije, i datëlindjes 27.12.1992, lindur në Tiranë dhe banues në rrugën “Ali Shefqeti”, Tiranë, me shtetësi shqiptare, beqar, në mungesë.

OBJEKTI: 1. Pushimit të hetimeve të akuzës së personin nën hetim Toni Shquti për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga neni 279 i Kodit penal. 2. Pushimit të hetimeve të akuzës së personin nën hetim Forcim Lita për veprën penale “Prodhimi dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit penal.

Në diskutimin përfundimtar palët kërkuar :

Prokuroria : Pranimin e kërkesës për pushimin e akuzës.

Deklarimin fajtor të pandehurit Toni Shquti, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje të narkotikës” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 6 vjet burgim. Në dhënien e masës së dënimit Gjykata të ketë parasysh aplikimin e nenit 406 pika 1 të K.Pr.Penal, mbi gjykim e shkurtuar. Lënda narkotike të asgjësohet. Detyrimin e të pandehurit për të paguar shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake në vlerën prej 3 000 Lekë.

Avokatja i të pandehurit kërkoi dënimin e të pandehurit me minimumin e dënimit dhe aplikimin e nenit 59 të kodit penal.

I pandehuri kërkoi një dënim sa më të butë.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, shqyrtoi provat dhe çështjen në tërësi

VËREN

Se organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë i është drejtuar Gjykatës me një kërkesë, e cila përmban dy kërkesa, përkatësisht :

1. Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 5978 të vitit 2021 me të pandehur Toni Shquti, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje të narkotikës” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal.

2. Pushimit të hetimeve të akuzës së personin nën hetim Toni Shquti për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga neni 279 i Kodit penal. Pushimit të hetimeve të akuzës së personin nën hetim Forcim Lita për veprën penale “Prodhimi dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit penal.

Nga ana procedurale kërkesa e prokurorit për dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe për pushimin e akuzës u shqyrtua në të njëjtën seancë gjyqësore në përputhje me nenin 329/a/2 të K.Pr.Penale që parashikon: *“Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq”*.

I pandehuri Toni Shquti, asistuar edhe nga avokatja e tij, kërkoi të procedohet me gjykim të shkurtuar. Duke qenë në këto rrethana, Gjykata vlerëson se duhet zbatuar neni 332/dh germa c) i K.pr.penal, sipas të cilit : *“ Pasi dëgjon diskutimet e palëve, Gjykata vendos : ... c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë”*.

Duke i marrë në harmoni frymën dhe germën e dy dispozitave të mësipërme, Gjykata vlerëson se si kërkesa për gjykimin e të pandehurit Toni Shquti ashtu edhe kërkesa për pushimin e hetimeve duhet të shqyrtohen në të njëjtin procedim dhe Gjykata duhet të shprehet për të dy kërkesat e mësipërme.

Organi i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesën për gjykimin e të pandehurit Elis Gjakova duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të mbajtjes dhe shitjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal, sipas së cilit :

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”

Meqenëse çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ndodhen aktet, bazuar në nenin 332/dh dhe 405 të K.Pr.Penale, Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit dhe të procedojë ndaj tij me gjykim të shkurtuar, qëndrim i cili është mbajtur edhe në Vendimin Unifikues nr 2 datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Këtij gjykimi në dallim nga gjykimi i zakonshëm i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Ligji parashikon që çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, që nënkupton pranimin e tyre nga palët, ashtu sikurse janë. Gjykimi vazhdon me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, të cilat i referohen akteve të pranuar nga palët ashtu sikurse parashikon neni 405/5 dhe 6 i K.Pr.Penale dhe gjykata jep vendim bazuar në to.”*

Sipas kërkesës së prokurorisë rezulton se:

Me datë 02.09.2021, rreth orës 14.00, nga ana e punonjësve të policisë të Sektorit të Forcës së Posaçme “Shqiponjat”, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, duke patrulluar në rrugën “Vangjush Furxhi”, Tiranë, ata kanë konstatuar katër shtetas të cilët dyshoheshin se mbanin me vete lëndë narkotike. Nga ana e policisë janë ndaluar shtetasit Toni Shquti, Forcim Lita, Korcagin Fejzullahu dhe Gert Shehu, të cilëve u është ushtruar kontroll fizik. Pas kontrollit fizik të këtyre personave, shtetasit Toni Shquti në çanten të cilen e mbante në dorë, ju gjetën katër doza me material bimor të dyshuar si lëndë narkotike si dhe një thikë. Shtetasit Forcim Lita gjatë kontrollit fizik iu gjet një cigare e mbushur me material bimor e dyshuar si lëndë narkotike kanabis sativa.

Në kushtet e flagrancës është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit Toni Shquti ku gjatë kontrollit në banesë, në dhomën e ndenjes është gjetur një qese plasmasi me mbishkrimin KMY, brenda të cilës ndodhej një tjetër qese ku kishte 70 doza me sasi materiali bimor i dyshuar si lëndë narkotike kanabis sativa.

Është bërë peshimi i lëndës narkotike që iu gjet gjatë kontrollit fizik të shtetasit Toni Shquti ku ka rezultuar se pesha e përgjithshme e saj me gjithë amballazh është 3.6 (tre pikë gjashtë) gram, e cila u sekuestrua me cilësinë e proves materiale dhe u fut në një qese me nr. UNIK X20000529 dhe u dërgua për ekspertim kimik.

Është bërë peshimi i lëndës narkotike që iu gjet gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Toni Shquti ku ka rezultuar se pesha e përgjithshme e saj me gjithë amballazh është 109.9 (njëqind e nëntë) gram, e cila u sekuestrua me cilësinë e proves materiale dhe u fut në një qese me nr. UNIK B20006483 dhe u dërgua për ekspertim kimik.

Është bërë peshimi i lëndës narkotike që iu gjet gjatë kontrollit fizik të shtetasit Forcim Lita ku ka rezultuar se pesha e përgjithshme e saj me gjithë amballazh është 0.6 (zero pikë gjashtë) gram, e cila u sekuestrua me cilësinë e proves materiale dhe u fut në një qese me nr. UNIK X20000529 dhe u dërgua për ekspertim kimik.

I është marrë mostra e urinës shtetasit Toni Shquti dhe është futur në qesen e provave material me numër unik B200006482 dërguar për ekspertim toksikologjik për të provuar nëse është përdorues i lëndës narkotike.

I është marrë mostra e urinës shtetasit Forcim Lita dhe është futur në qesen e provave material me numër unik B200006482 dërguar për ekspertim toksikologjik për të provuar nëse është përdorues i lëndës narkotike.

Është marrë deklarimi i shtetasit Toni Shquti i cili shpjegon se është përdorues i rregullt i lëndës narkotike prej njëzet vjetësh dhe lënda narkotike e sekuestruar nga policia është e tija, të cilen e ka patur për përdorim vetjak.

Eshtë marrë deklarimi i shtetasit Forcim Lita i cili shpjegon se është përdorues i rregullt i lëndës narkotike prej tre vjetësh dhe lënda narkotike e sekuestruar nga policia është e tija, të cilën e patur për përdorim vetjak. Këtë sasi lënde narkotike ia ka blerë shtetasit Toni Shquti.

Janë pyetur shtetasit Gert Shahu dhe Korcagin Fejzullahu të cilët deklarojnë se nuk kanë qenë jeni të lëndës narkotike.

Eshtë kryer ekspertimi kimik i materialit bimor të kapur personit të pandehurit Toni Shquti dhe me aktin e ekspertimit nr. 11879, datë 19.11.2021 ka rezultuar se: Materialet bimore, objekt ekspertimi, janë Cannabis, product verbal i bimes Cannabis Sativa L. Pesha pa amballazh e materialeve bimore objekt ekspertimi në total është 2.805 gram.

Eshtë kryer ekspertimi kimik i materialit bimor të kapur në banesën e personit të pandehur Toni Shquti dhe me aktin e ekspertimit nr. 12592 datë 17.12.2021 ka rezultuar se: Materialet bimore, objekt ekspertimi, janë Cannabis, product verbal i bimes Cannabis Sativa L. Pesha pa amballazh e materialeve bimore objekt ekspertimi në total është 62 gram.

Sipas aktit të ekspertimit toksikologjik nr. 2337, datë 24.09.2021 ka rezultuar se në mostren e urines se marre shtetasit Toni Shquti, nuk u zbulua prania e produkteve kanabinoike të metabolizmit të bimes Cannabis Sativa L, në organizmin e njeriut.

Sipas aktit të ekspertimit toksikologjik nr. 2336, datë 24.09.2021 ka rezultuar se në mostren e urines se marre shtetasit Forcim Lita u zbuluan në nivel gjurme produktet kanabinoidike të metabolizmit të bimes Cannabis Sativa L, në organizmin e njeriut.

Nga ana e policisë pasi janë kryer veprimet e para hetimore është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Toni Shquti për veprën penale të "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Sipas aktit të ekspertimit teknik të thikës së sekuestruar nr. 377, datë 08.09.2021, ka rezultuar se thika objekt ekspertimi nuk i plotëson kushtet teknike të armëve të ftohta me teh. Duke qenë se thika e sekuestruar të pandehurit Toni Shquti nuk i plotëson kushtet teknike të armës së ftohtë, ai nuk mund të akuzohet për veprën penale të "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të ftohta", parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal.

Në analizë të fakteve të sipërpërmendura arrijmë në përfundimin se i pandehuri Toni Shquti ka konsumuar veprën penale të "Prodhim dhe shitje e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, prandaj duhet marrë në përgjegjësi penale.

Faktet e përmendura më lart rezultuan të provuara me aktet e paraqitura nga organi i prokurorisë, të cilat për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar marrin vlerën e provës në gjykim (qëndrim i cili është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr 2 datë 29.01.2003). Konkretisht :

- Nga procesverbali i kapjes në flagrancë të të pandehurit datë 02.09.2021 rezulton e provuar koha dhe vendi i kapjes së të pandehurit, qesja me lëndë narkotike e gjetur të pandehurit në momentin e ndalimit, sendet e tjera të sekuestruara, etj.
- Nga procesverbali i përshkimit dhe peshimit të lëndës së sekuestruar dhe nga procesverbali i sekuestrimit të saj datë 02.09.2021, ku janë përshkruar hollësisht lënda e sekuestruar, pesha e detajuar e saj me dhe pa ambalazh, është përshkruar mënyra e ambalazhimit, etj.
- Nga procesverbali i kontrollit të banesës së të pandehurit, ku është pasqyruar kontrolli i ushtruar, gjetja e një sasive lënde të dyshuar si cannabis sativa, përshkrimi i saj, peshimi, etj.
- Nga akt ekspertimi toksikologjik ku është bërë analizimi i urinës së të pandehurit dhe është arritur në konkluzionin se në urinën e tij nuk u zbulua prania e produkteve të lëndëve narkotike.

- Nga akt ekspertimi kimik, ku është bërë analizimi i lëndës së sekuestruar të pandehurit dhe është arritur në konkluzionin se lenda e sekuestruar ne ngjarjen e mesipërme, objekt ekspertimi tregon për praninë e canabis dhe se bën pjesë në grupin e lëndëve narkotike sipas parashikimeve të ligjit nr.7975 datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”.

Gjatë hetimeve paraprake, vetë i pandehuri, nuk e ka kundërshtuar akuzën duke pretenduar se është përdorues i lëndës narkotike dhe lenda e gjetur ishte për përdorim vetiak. Të njejtin qëndrim i pandehuri ka mbajtur edhe në gjykim duke u shprehur se është i penduar dhe se kërkonte një dënim sa më të butë.

Sa më sipër Gjykata krijon bindjen se provat janë të plota, të harmonizuara dhe krijojnë bindjen se i pandehuri Toni Shquti ka kryer veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal. I pandehuri me dashje ka mbajtur në ambient publik dhe banesë një sasi lënde të klasifikuar ligjërisht si narkotike pa qenë i pajisur me leje përkatëse apo për shkaqe të justifikuara.

I pandehuri me veprimet e tij të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar kontrollin mbi lëndët narkotike dhe psikotrope si edhe rendin publik në përgjithësi. I pandehuri është në gjendje të kuptojë dhe kontrollojë veprimet e tij dhe pasojat që vijnë prej tyre, ka mbushur moshën 18 vjec dhe prandaj duhet të përgjigjet penalisht.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit Gjykata mban parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe të të pandehurit. Kështu :

- Vepra penale e prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike po haset vazhdimisht dhe është një nga problemet shqetësuese i realitetit shoqëror shqiptar,
- Sasinë dhe llojin e lëndës narkotike të gjetur të pandehurit,
- Rrethanat e gjetjes së saj,
- Mënyrën e jetesës së të pandehurit
- Gjendjen ekonomiko sociale të të pandehurit si edhe
- Qëndrimin pohues dhe pendues të të pandehurit.

Duke i marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e mësipërme, Gjykata vlerëson se i pandehuri Toni Shquti duhet të dënohet me burgim sipas parashikimeve të nenit 283 pg.1 i kodit penal.

Në lidhje me pretendimin për aplikimin e nenit 59 të Kodit penal, Gjykata vlerëson se nuk janë kushtet për zbatimin e dënimeve alternative pasi i pandehuri deklarohet i dënuar edhe më parë si edhe lloji dhe ndarja në porcione i lëndës narkotike, krijojnë dyshimin se ai mund të jetë shpërndarës apo shitës i lëndës narkotike.

Për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar, i pandehuri përfiton edhe uljen e 1/3 së dënimit sipas parashikimeve të nenit 406 të K.pr.penale.

Lidhur me provat materiale, qarkullimi i lëndës narkotike është i ndaluar dhe në zbatim të nenit 190 të k.pr.penale duhet të urdhërohet asgjësimi i saj.

Në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzave, Gjykata vëren se :

Neni 328 pg.1 germa b i K.Pr.Penale ka përcaktuar se:

“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

- a) del qartë se fakti nuk ekziston;
- b) fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale;
- c) viktimi nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;
- ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;
- d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë;
- dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;
- e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën veprë penale;
- ë) i pandehuri vdes;
- f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.;

I njëjti përcaktim duhet zbatuar edhe në çështjen objekt gjykimi, pasi neni 329/a pg.1 i K.Pr.Penale ka parashikuar se: “1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.”

Në çështjen objekt gjykimi, roli i Gjykatës është përcaktuar nga neni 329/b pg.3 i K.Pr.Penale, sipas të cilit: “3. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes....”.

Nga aktet e paraqitura në gjykim rezulton se shtetasit Forcim Lita i është gjetur dhe sekuestruar një cigare me lëndë narkotike canabis sativa me peshë 0.6 (zero pikë gjashtë) gramë. Gjykata çmon se në çështjen objekt gjykimi jemi para rastit që përjashton nga përgjegjësia penale në kuptim të paragrafit të parë të nenit 283 të Kodit Penal. Këtë përfundim gjykata e nxjerr bazuar në dy elementë :

I. Së pari, doza e gjetur në mjetin e personin nën hetim konsiderohet si dozë e vogël në kuptim të nenit 283/1 të Kodit Penal, pasi nga procesverbali i peshimit rezulton se pesha e lëndës narkotike me ambalazh është 0.6 gramë. Këto fakte vlerësohen edhe në raport me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1 datë 27.03.2008 që parashikon: “Doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël.”

Në këto kushte, gjykata çmon se doza prej 0.6 gramë e lëndës narkotike canabis konsiderohet dozë e vogël në kuptim të nenit 283/1 të Kodit Penal.

II. Së dyti, rezulton se personi nën hetim Forcim Lita është përdorues i lëndës narkotike, fakt ky i provuar si nga akti i ekspertimit të urinës ashtu edhe nga deklaratimet e të pandehurit, sipas të cilit rezulton se personi nën hetim është përdorues i lëndës narkotike.

Nga ana e organit procedues, nuk u paraqit asnjë dyshim që i pandehuri të mbajë lëndën narkotike përveç se për përdorim vetiak. Ndalimi i tij ka qenë i rastësishëm dhe nuk ka indicie që i pandehuri të jetë kontigjent kriminal në fushën e paligjshmërisë së lëndëve narkotike.

Gjithashtu ai ka dhënë deklaratim duke pretenduar se lëndën e ka blerë tek i pandehuri Toni Shquti.

Në këto kushte, Gjykata çmon se në çështjen objekt gjykimi plotësohen të dy kushtet që përjashtojnë ekzistencën e veprës penale dhe rrjedhimisht edhe të përgjegjësisë penale për veprën penale “Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës të parashikuar nga neni 279 i Kodit penal në ngarkim të të pandehurit Toni Shquti, Gjykata çmon se kërkesa është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

Në rastin konkret, i pandehuri Toni Shquti është dyshuar se ka patur në cantën e tij një mjet thikë. Sipas aktit të ekspertimit teknik nr 377, date 08.09.2021 ka rezultuar se thika objekt ekspertimi nuk i ploteson kushtet teknikes të armës së ftohtë. Duke qenë kështu, mungon ana objektive e veprës penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga neni 279 i Kodit penal.

Për këto arsye, Gjykata krijoi bindjen dhe bazuar në nenin 329/b, 390 dhe 379 të K.Pr.Penale

VENDOSI

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Toni Shquti (i biri i Eqrem dhe i Qanije, i dtl. 21.10.1986) për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet e 6 muaj burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.pr.penale ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri Toni Shquti dënohet me 3 (tre) vjet e 8 muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Toni Shquti fillon nga dita e ndalimit datë 02.09.2021 dhe të vuhet në një nga burgjet e sigurisë së zakonshme.

Bazuar në nenin 190 të k.pr.penale provat materiale 112.9 (njëqind e dymbëdhjetë pikë nëntë) gramë lëndë narkotike cannabis sativa me gjithë ambalazh të asgjësohet, ndërsa provat e tjera t’i kthehen personave që u përkasin.

Shpenzimet proceduriale i ngarkohen të pandehurit Toni Shquti.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga i pandehuri dhe/ose prokurori në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

2. Pushimin e akuzës së personit nën hetim Toni Shquti për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga neni 279 i Kodit penal.

Pushimit të hetimeve të akuzës së personin nën hetim Forcim Lita për veprën penale “Prodhimi dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit penal.

Kundër vendimit për pushimin e akuzës lejohet ankim nga i pandehuri dhe/ose viktima brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall me 23.02.2022.

SEKRETARE

GJYQTAR

Mimoza Noka

ALBERT MEÇA

Shpenzimet gjyqesore

Fletëhirje nje cope 150(njeqind e pesedhjete) leke

Avokat kryesisht 3.000(tre mije) leke

Shpenzime hetimore 10300(djetemije e treqind) leke.